



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 17.10.2024

Nr: 23

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 13, DATË 11.10.2024 DEPOZITUAR NGA
Z. ASTRIT FADIL KAZIU

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në seancën e datës 17.10.2024, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKIMUES:

Z. Astrit Fadil Kaziu, kandidat për anëtar i Këshillit Bashkiak Peqin nga lista shumëemërore e subjektit zgjedhor Partia Socialiste të Shqipërisë.

OBJEKT:

Kundërshtim i vendimit nr. 181, datë 08.10.2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për plotësimin e vakancës së krijuar në Këshillin Bashkiak Peqin, nga mandati i ndërprerë i këshilltarit zj. Anxhela Tabaku me zj. Donika Ded Karina e cila në listën shumëemërore të kandidatëve për anëtar këshilli të subjektit zgjedhor Partia Socialiste të Shqipërisë mban numrin 13 (trembëdhjetë)“

BAZË LIGJORE:

Nenet 21, pika 1, shkronja “b”, neni 123/1 dhe pika 3, e neni 124 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Data: 17.10.2024 Nr: 23
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 13, datë 11.10.2024 depozituar nga z. Astrit Fadil Kaziu”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në përfundim të shqyrtimit administrativ të kërkesës ankimore nr. 13, datë 02.08.2024 pasi dëgjoi relatimin e anëtarit Elvis Çefa, dëgjoi palët prezente në seancë dhe shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

V Ë R E N S E:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES:

1. Me shkresën nr. 1456 prot., datë 22.07.2024, këshilli i bashkisë Peqin, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Anxhela Shkëlqim Tabaku, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.
2. Sipas qëndrimit të mbajtur edhe në raste të tjera analoge nga KQZ, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Peqin, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 13, zj. Donika Ded Karina, referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar,
3. Në këto kushte, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Peqin zj. Donika Ded Karina, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.
4. Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.
5. Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.
6. Duke qenë se, në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit është konstatuar se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Donika Ded Karina, në Këshillin e Bashkisë Peqin, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit nr. 181, datë 08.10.2024 “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Peqin, me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Socialiste të Shqipërisë” zj. Donika Ded Karina”, ka vendosur plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Peqin, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Donika Ded Karina.

7. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kërkesë ankimore z. Astrit Fadil Kaziu, i cili është gjithashtu kandidat nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Peqin dhe ka numër rendor 10. Ankuesi pretendon se vakanca e krijuar në Këshillin e Bashkisë Peqin i përket atij dhe për këtë arsye kërkon shfuqizimin e vendimit nr. 181, datë 08.10.2024 të KSHZ.

8. Në ankimin e tij drejtuar KAS, z. Kaziu parashtron:

Ne referim të neni 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, femrat (anëtare keshilli) ne Keshillin Bashkiak Peqin te subjektit zgjedhor Partia Socialiste nuk janë gjini e nënperfaqësuar (anëtare keshilli të Partise Socialiste ishin 5 femra dhe 4 meshkuj), madje Kryetar i Keshillit është femer.

Ne neni 2, në pikën 26 thuhet të Kodit Zgjedhor thuhet se "Gjini e nënperfaqësuar" është gjinia me tradicionalisht numrin më të vogël të anëtarëve në Kuvend ose, sipas rastit, në keshillat vendorë në rang vendi.

Unë nuk di sa është numri i këshilltarëve femra dhe meshkuj në rang vendi, unë nuk di sa është numri i femrave dhe meshkujve anëtarë këshilli te subjektit zgjedhor Partia Socialiste në rang vendi. Subjektet zgjedhore sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor pika 9 kanë detyrimin që të respektojnë rregullin që "ne zgjedhjet për këshillat bashkiakë një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje ta kandidatëve të subjekteve zgjedhore duhet ti perkasë se njejtës gjini". Unë gjykoj se vijimi i listes duhej të vazhdoje me nr. 10 qe është emri im, vijim i cili nuk shkel Ligjin Nr.9970, datë 24.7.2003 "Për barazinë gjinore ne shoqëri", neni 15, pika 1, ku thuhet:

1. Perfaqesimi i barabartë gjinor ne të gjitha organet-e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike arrihet kur: c) sigurohet përfshirja mbi 30 per qind e seciles gjini në listën e kandidatëve per zgjedhjet në organet Përfaqesuese vendore;

9. Kërkesa ankimore nr. 13, iu paraqit KAS-it, me relator anëtarin z. Elvis Çefa. KAS pasi vlersoi në seancë paraprake përputhshmërinë me Kodin Zgjedhorë të elementëve formalë të kërkesës ankimore, vendosi pranimin e saj për shqyrtim. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit më datë 17.10.2024, ora 11:00. Në seancë ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretarja e Përgjithshme zj. Majlinda Çelmeta dhe ankuesi z. Astrit Fadil Kaziu.

10. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesat Ankimore nr. 13, datë 11.10.2024 të depozituar nga z. Astrit Fadil Kaziu;
- Vendimin nr. 181, datë 08.10.2024 "Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Peqin, me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë" zj. Donika Ded Karina", të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe dokumentacionin shoqëruar të tij.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i VLERËSON SE:

1. Dispozita e Kodit Zgjedhor e cila duhet marrë fillimisht në analizë për të konkluduar drejt lidhur me ankimin e paraqitur është pikërisht pika 2 e nenit 164 në të cilën sanksionohet se: *“2. Mandati i ndërprerë i deputetit ose i anëtarit të këshillit të bashkisë i kalon kandidatit vijues të listës së të njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, përveçse kur plotësimi i vakancës me kandidatin e radhës ul përfaqësimin e gjinisë së nënpërfaqësuar. Në këtë rast plotësimi i vakancës bëhet nga kandidati i parë në listë i gjinisë së nënpërfaqësuar pavarësisht renditjes në listë. Emrat e tjerë të asaj gjinie ngjiten në listë duke marrë renditjen e kandidatit paraardhës të së njëjtës gjini. Ky rregull nuk zbatohet kur emrat e gjinisë përkatëse kanë shteruar.”*.
2. Në interpretim të kësaj dispozite, rezulton se rregulli i përgjithshëm i aplikueshëm në rastin e plotësimit të vakancës së krijuar në një këshill bashkiak është se mandati i kalon kandidatit vijues të listës të së njëjtës parti politike. Në rastin konkret, në aplikim të vetëm këtij rregulli, duke qenë se anëtari i këshillit që ka lënë mandatin kishte numrin 9 (nëntë) në listën shumëemërore të Partisë Socialise, në dukje mandati i ndërprerë do të duhej ti kalonte ankimuesit, i cili ka numrin 10 (dhjetë) në listën shumëemërore të Partisë Socialiste për këshillin bashkiak Peqin.
3. Por, në mënyrë që të aplikohet rregulli i cituar më sipër në dhënien e mandatit të ndërprerë, Kodi Zgjedhor ka vënë si kusht respektimin edhe të rregullit të përshkruar në pjesën e dytë të dispozitës së lartpërmendur, sipas të cilit: duhet verifikuar paraprakisht nëse dhënia e mandatit kandidatit vijues (në rastin konkret ankimuesi, i cili ka nr 10 në listë), ul ose jo përfaqësimin e gjinisë së nënpërfaqësuar në këshillin bashkiak në fjalë.
4. Është fakt i ditur botërisht se në kuptim të pikës 26 të nenit 2 të Kodit Zgjedhor, në Shqipëri në rang kombëtar gjinia që tradicionalisht ka numrin më të vogël të anëtarëve në Kuvend ose në këshillat vendorë është ajo femërore. Kjo do të thotë që “gjini e nënpërfaqësuar” në kuptim të Kodit Zgjedhor do të konsiderohet gjinia femërore, pra në rastin konkret gratë në këshillin bashkiak Peqin.
5. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë faktin se këshilltari i cili ka lënë mandatin e tij, i përkiste gjinisë femërore, pra gjinisë së nënpërfaqësuar, në dhënien e mandatit të personit vijues në listën e subjektit plotik PS, KQZ duhet detyrimisht të ruajë numrin e anëtarëve gra që ishin ndërkohë në këshillin bashkiak Peqin, përpara ndërprerjes së mandatit nga anëtarja e këshillit e cila është larguar. Pra në këtë rast, në mënyrë që numri i anëtarëve gra në atë këshill të mbetet i pacënuar edhe pas plotësimit të vakancës së krijuar nga ikja e një këshilltari grua, KQZ është e detyruar ti japë mandatin gruas së parë në radhë në listën shumëemërore të të njëjtit subjekt politik.

6. Thënë ndryshe, nëse KQZ do të vijonte me dhënien e mandatit zëvendësues vetëm mbi bazën e kriterit të renditjes në listën shumëemërore të të njëjtit subjekt zgjedhor, pra do ti jepte mandatin ankimuesit i cili ka nr. 10 në atë listë, pasoja e drejtpërdrejtë e këtij veprimi do të ishte ulja e numrit të grave në këshillin bashkiak përkatës. Ky veprim do të binte ndesh me parashikimin e pikës 2 të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, i cili është ligji i aplikueshëm në këtë rast.
7. Në këtë mënyrë, me vendimin objekt ankimi KSHZ duke i dhënë mandatin e anëtarit të këshillit bashkiak gruas së parë në listën shumëemërore të të njëjtit subjekt politik të cilin i përkiste edhe anëtari grua i këshillit bashkiak që dorëzoi mandatin, ka respektuar një detyrim të sanksionuar nga Kodi Zgjedhor.
8. Në këto kushte KAS vlerëson se vendimi nr. 181, datë 08.10.2024 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për plotësimin e vakancës së krijuar në Këshillin Bashkiak Peqin, nga mandati i ndërprerë i këshilltarit zj. Anxhela Tabaku me zj. Donika Ded Karina e cila në listën shumëemërore të kandidatëve për anëtar këshilli të subjektit zgjedhor Partia Socialiste të Shqipërisë mban numrin 13 (trembëdhjetë)", është i drejtë dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi ndërkohë që ankimi i bërë kundrejt këtij vendimi nga z. Astrit Fadil Kaziu duhet të rrëzohet si i pambështetur në ligj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja "b" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 13, datë 11.10.2024 të depozituar nga z. Astrit Fadil Kaziu.
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 181, datë 08.10.2024 "Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Peqin, me kandidatin nga lista shumëemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë " zj. Donika Ded Karina", të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

U shpall sot me datë 17.10.2024.

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar